

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e Studimit Master i Shkencave (PI) në “Arkitekturë”

SHKOLLA E LARTE UNIVERSITARE JOPUBLIKE

“UNIVERSITETI MARIN BARLETI”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Dr. Denada Veizaj

PhD. Odeta Manahasa

Shtator, 2019

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master i Shkencave (Program i Integruar-PI) në "Arkitekturë"

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Shkolla e Larte Universitare Jopublike "Universiteti "Marin Barleti""
2	Fakulteti / Departamenti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike
3	VKA/ Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKA Nr. 522, datë 18.07.2013 Urdhër nga MAS, Nr. 394, datë 06.10.2014
4	Akreditimi i programit	Në proces
5	Titulli i programit të studimit:	Master i Shkencave (PI) në "Arkitekturë"
6	Cikli i studimit:	Cikli II
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/ në distancë):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet vetëm nga institucioni	PO
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	JO
13	Diplomë e përbashkët /Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	JO
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
15	Numri i studentëve	86

Shënim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Shkolla e lartë universitare jopublike "Universiteti Marin Barleti" ka filluar aktivitetin e saj me 2005 dhe aktualisht është e kompozuar në 2 Fakultete, 6 Departamente dhe 3 Qendra kërkimore. Ajo ofron studime e kualifikime në diplomat *profesionale*, diplomat *Bachelor*, *Master Profesional* dhe *Master i Shkencave*.

Licencimi për programin e studimit Master i Shkencave (PI) në "Arkitekturë" (më tej MSHA) është bërë përmes Urdhrit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Nr. 394 me datë 06.10.2014, pra programi është në vitin e tij të pestë duke diplomuar studentë për herë të parë.

Njësia Kryesore që ofron këtë program studimi është Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë, kurse Njësia Bazë përgjegjëse është Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike, (Sipas shkresës "Informacion mbi mënyrën e organizimit të programeve të studimit sipas Departamenteve në UMB", datë 26.03.2018)

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Dr. Denada Veizaj

PhD. Odeta Manahasa

Menaxheri Teknik i vlerësimit të këtij program studimi është specialisti i ASCAL Renata Qatipi.

Më datë 02.08.2019, përmes sistemit AMS, SHLUJ "Universiteti "Marin Barleti"" është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Më datë 09.09.2019, SHLUJ "Universiteti "Marin Barleti"" përcjell zyrtarisht përgjigjen për Draft –Raportin, me shkresë Nr. 2711 Prot., datë 09.09.2019, "*Kthim përgjigje, për Raportin e vlerësimit të jashtëm, për programin e studimit Msc (PI) në Arkitekturë*". Në këtë dokument institucioni ka bërë disa komente për Draft-RVJ.

Në përgjigje të shkresës së Zëv-Rektorit të SHLUJ UMB me Nr. 2711 Prot, Dt. 09.09.2019 "*Kthim përgjigje për raportin e vlerësimit të jashtëm për programin e studimit Master i Shkencave (PI) në "Arkitekturë", Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi vlerësoi komentet e bëra, shprehet si më poshtë.*

Konkluzione të ekspertëve në Draft RVJ: Misioni/ Objektivat e programit të studimit. Rekomandohet:

1. *Rekomandohet hartimi i dokumenteve strategjike në nivel njësie bazë/kryesore ku artikuloohen vizionet dhe misioni i programit të studimit si dhe mënyrat e përmirësimit të vazhduar të tij.*

Argumentim nga SHLUJ UMB: SHLUJ UMB është në fazën e hartimit të strategjisë institucionale. Gjatë vitit akademik 2018-2019 ka nisur procesi i hartimit të strategjisë dhe konsultimit me departamentet. Edhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit është duke punuar për këto dokumente. Për evidence po ju dërgojmë bashkëlidhur praktiken e hartimit të strategjisë për vitin 2020 në proces.

Përgjigje e GVJ: *Procesi i vlerësimit ka konsideruar të gjithë dokumentet ekzistues deri në momentin e nisjes së procesit. Çdo dokument në hartim e sipër pas këtij momenti mund të konsiderohet nga procesi pasardhës i akreditimit. Argumenti nuk merret parasysh.*

Konkluzione të ekspertëve në Draft RVJ: Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit. Rekomandohet:

1. *Rritje e numrit të stafit të kategorisë profesor*

2. *Rritja e numrit të stafit të kategorisë lektor me synim uljen e ngarkesës vjetore të stafit aktual si dhe uljen e numrit të disiplinave që çdo anëtar jep. Kjo do të shkonte në favor të rritjes së cilësisë.*

Argumentim nga ShLUIJ UMB: Në lidhje me rekomandimin e eksperteve të vlerësimit, saktësojmë se departamenti e ka prioritet si rritjen cilësore dhe atë sasiore të stafit kjo është pasqyruar më së miri në rritjen ndër-vite si të numrit ashtu edhe të gradave të pedagogëve efektivë edhe me kohë të pjesshme. Ndërkohë, në lidhje me rekomandimin për rritjen e stafit të kategorisë profesor, saktësojmë se pavarësisht kërkesës së departamentit dhe shpalljeve të herëpashershme, vërejmë se në tregun vendas ka mungesë pedagogesh të kategorisë profesor sidomos në Arkitekturë.

Përgjigje e GVJ: *Argumenti mbi rekomandimin 1 “Rritja e numrit të stafit të kategorisë Profesor” është i qëndrueshëm, duke konsideruar kontekstin shqiptar. Argumenti Pranohet. Ndërkohë rekomandimi për rritjen e numrit të stafit të kategorisë Lektor, me synim uljen e ngarkesës vjetore të stafit qëndron. Kjo referuar pasqyrës së ngarkesës vjetore/javore të deklaruar, si edhe numrit të disiplinave për pedagog.*

Konkluzione të ekspertëve në Draft RVJ: Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit. Rekomandohet:

1. *Të përmirësohet gjendja e botimeve lidhur me programin e studimit në bibliotekën e universitetit*
2. *Të përmirësohen në terma fizike e në nivel mobilimi ambientet dedikuar laboratorëve të projektimit*

Argumentim nga ShLUIJ UMB:

1. Departamenti ndan të njëjtin mendim me ekspertët nisur dhe nga fakti që literatura në gjuhën shqipe është e kufizuar, megjithatë çdo vit departamenti nëpërmjet procedurës tashmë të ngritur në ShLUIJ UMB për pasurimin e bibliotekës blen çdo vit tituj të rinj. Bashkëlidhur procedura e blerjes së librave.
2. Nga ky vit akademik Departamenti ka në përdorim 4 laboratorë projektimi, ku 3 (tre) nga këto janë në Godinën C dhe 1 (një) në Godinën B të cilat mendojmë se janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme në raport me numrin e studentëve të programit të Arkitekturës.

Përgjigje e GVJ: *Siç edhe pranohet nga institucioni, rekomandimi i parë është i qëndrueshëm. Në lidhje me argumentimin e dytë, rekomandimi nuk fokusohet tek raporti numër studentesh/hapësirë, por në cilësitë fizike të hapësirës si dhe në elementet e mobilimit. Argumenti nuk merret parasysh*

Konkluzione të ekspertëve në Draft RVJ: Financimi dhe menaxhimi burimeve financiare Rekomandohet:

1. *Hartimi i politikave që synojnë lidhjen e institucionit me tregun, duke siguruar burime të tjera financimi, përveç tarifave të studenteve.*
2. *Rekomandohet që zëri i granteve për kërkim shkencor të marrë peshë në buxhetet vjetore afatmesëm e afatgjatë*

Argumentim nga ShLUIJ UMB: Si edhe mund të vihet re në tabelën nr 8 në RVB paraqiten të dhënat përmbledhëse të pasqyrave financiare të të gjithë periudhës në akreditim sipas bilanceve të deklaruara në tatime. Po ju dërgojmë bashkëlidhur të ardhura të tjera nga shfrytëzimi për tre vitet e fundit ku mund të gjeni informacione të detajuara edhe në lidhje me të ardhurat nga grante dhe projekte të ndryshme, të cilat janë përmbledhur në tabelat e paraqitura në RVB nën zërat Konsulenca, shërbime dhe Shërbimet trajnuese (kualifikimi i vazhdueshëm). [Bashkëlidhur të ardhurat për zërat e mësipërm për tre vitet e fundit]

Përgjigje e GVJ: *Argumenti shoqëruar edhe me dokumentacionin shtesë pranohet.*

Konkluzione të ekspertëve në Draft RVJ: Sistemi i brendshëm i cilësisë. Rekomandohet që:

1. Njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit të përpilojë raport vjetor të punës didaktike dhe kërkimore.
2. Të hartohet një praktike e bazuar në raport vjetor e plan veprimi vjetor i cili synon të rikuperojë problemet e evidentuara nga raporti.
3. Strukturimi i departamentit në grupe mësimore të cilat janë përgjegjëse për të gjitha nivelet e analizave që bëhen në nivel lënde, grup-lëndësh apo edhe kurrikulës në tërësi.

Argumentim nga ShLUJ UMB: Duke filluar nga viti akademik 2018-2019 departamentet hartojnë një plan veprimi për çdo vit akademik dhe në fund të vitit hartohen një raport me arritjet dhe nevojat, dhe mbi bazën e tyre hartohet plani i vitit akademik pasardhës. Bashkangjitur ju dërgojmë planin dhe raportin vjetor për vitin akademik 2018-2019. Vlerësojmë rekomandimin e eksperteve për organizimin e stafit sipas grup-lendeve.

Përgjigje e GVJ: *Argumenti lidhur me rekomandimin 2, bazuar edhe në dokumentacionin shoqëruar pranohet. Ndërkohë për rekomandimin 1 nuk ka argumentim dhe për përmbajtjen e rekomandimit nr. 3 edhe institucioni dakordësohet.*

Konkluzione të ekspertëve në Draft RVJ: Programi i studimit, organizimi i tij. Rekomandohet:

1. Rekomandohet të shihet zbërthimi në auditor i tezës, e cila duhet të rezultojë me 20 orë faktike (në auditor) javore në semestrin e dytë të vitit të pestë.
2. Rekomandohet të shtohet gradualisht numri i disiplinave/moduleve të lendeve që orientojnë formimin drejt profilit në fjalë.

Argumentim nga ShLUJ UMB:

1. Departamenti ndan të njëjtin mendim me grupin e vlerësimit duke e reflektuar këtë rekomandim në vendimin e tij nr 3 datë 15.05.2019, miratuar nga senati dhe aprovuar nga Ministria e Arsimit; Sportit dhe Rinisë, Nr Prot. 5730/1 datë 11.06.2019 ku ka vendosur lëndën e re "Laborator Diplome", 10 orë javore në auditor që do të zhvillohet në semestrin e dytë të vitit të pestë. Këto ndryshime do të aplikohen për këtë vit akademik 2019-2020, (ju lutem referojuni planit mësimor bashkëlidhur dhe dokumenteve relativ përkatës).
2. Referuar këtij rekomandimi, saktësojmë se programi i studimit aktual është profili arkitekt dhe kurrikula është e përshtatur për këtë profil. Në lidhje me orientimin e programit të studimit drejt formimit të një arkitekti-restaurator, siç edhe e evidentojnë ekspertet, kjo është një tendencë e cila kërkon studim të mirëfilltë tregu dhe si e tillë i takon një vlerësimi në të ardhmen.

Përgjigje e GVJ: *Për rekomandimin 1 edhe institucioni dakordëson lidhur me përmbajtjen. Rekomandimi i dytë ka ardhur si rrjedhojë e intervistave në institucion dhe aspiratës së tij. Megjithatë argumenti i institucionit pranohet, për sa kohë procesi i vlerësimit lidhet me programin aktual.*

Konkluzione të ekspertëve në Draft RVJ: Kërkimi shkencor. Rekomandohet:

1. Ndërtimi i grupeve kërkimore në njësinë bazë që siguron rezultate kërkimore. Do të ishte e këshillueshme ngritja e këtyre grupeve si dhe zhvillimi i një profili të qarte kërkimor.

Argumentim nga ShLUJ UMB: Kërkimi shkencor është një komponent i rëndësishëm i departamentit dhe për këtë anëtarët e tij janë të angazhuar në institutet kërkimore të Universitetit. (ADRIAPOL, BIRD, AIPA) të cilat janë njësi të angazhuara tërësisht në kërkimin shkencor dhe të aplikuar. Kryesisht grupi i pedagogëve të angazhuar në këtë 5 vjeçar janë profilizuar drejt Rikualifimit dhe Rivitalizimit të godinave industriale.


Përgjigje e GVJ: Rekomandimi i është referuar ligjit të arsimit të lartë 80/2015, i cili e sheh departamentin të strukturuar në grupe kërkimore. Nëse këtë proces e mbulojnë institutet, kërkohet koordinim mes punës së tyre dhe proceseve të mësimdhënies në departament, që të sigurohet lidhja kërkim/mësimdhënie. Kur këto struktura janë në varësi direkte të departamentit, kjo lidhje është me e natyrshme. Megjithatë, argumenti i institucionit, bazuar edhe në dokumentacionin shtesë referuar produktit kërkimor pranohet.

Konkluzione të ekspertëve në Draft RVJ: Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun. Rekomandohet:

1. *Intensifikimi i bashkëpunimeve të mëtejshme, jo vetëm në mobilitet dhe projektet e përbashkëta kërkimore akademike por edhe me botën e industrisë.*

Argumentim nga ShLUJ UMB: Departamenti përveç mobilitetit dhe projektet e përbashkëta kërkimore akademike ka edhe kontribut në kërkimin e aplikuar (botën e industrisë)

Përgjigje e GVJ: Argumenti shoqëruar edhe me dokumentacionin shtesë pranohet.



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Formimi në disiplinën e Arkitekturës konsiderohet si një set veprimtarish komplekse të cilat i qasen proceseve didaktike e atyre kërkimore si entitete ndërvepruese. Një element tjetër me po aq rëndësi në formimin e arkitektëve të rinj është ndër-disiplinariteti, duke synuar drejt një edukimi që ndërlihdh nocione nga shkencat ekzakte dhe atyre humane. Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike ofron një kurrikul edukimi e cila tenton të jetë konform këtyre principeve të përgjithshme e tenton t'i shprehë në të gjithë elementet e programit të studimit si edhe në dokumentet strategjike që lidhen me këtë program.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Edukimi në arkitekture është i lidhur me momentin e zhvillimit të Shqipërisë, i reflektuar në nevojën e tregut për profesionistë arkitektë si dhe në një zhvillim të vullshëm të sektorit të ndërtimit e zhvillimit të ambientit të ndërtuar. Të ofruarit të specialisteve të aftë për tu përballur me sfidat që vendos ky <i>momentum</i> zhvillimi kthehet në misionin e institucioneve të arsimit në përgjithësi si dhe të SHLUIJ “Universiteti Marin Barleti” në veçanti. Siç u artikulua gjatë takimit me autoritetet drejtuese të tij, përgjegjëse për institucionin dhe programin e studimit në fjale, të ofruarit të këtij programi vjen si përgjigje ndaj nevojave të tregut dhe gjendjes së zhvillimit të vendit. Ajo çka u verifikua nga komunikimi me autoritetet akademike drejtuese është synimi për të ofruar një profil arkitekti me orientim nga restaurimi e arkeologjia, si një element i munguar në tregun e sotëm të profesionisteve.</p> <p>Duke iu referuar dy dokumenteve të vëna në dispozicion, Planit strategjik të IAL-së dhe studimit të tregut për këtë program studimi lexohet tendenca për të përfshirë vizionin në terma makro të universitetit në elementet e programit të studimit. Ndërkohë dokumenti i vënë në dispozicion në lidhje me strategjinë e njësisë bazë që ofron programin e studimit paraqet praktiken procedurale dhe një template se si duhet strukturuar dokumenti strategjik.</p> <p>Template i atashuar duket i strukturuar në terma të vizionit dhe objektivave. Rekomandohet të shtohen afatet kohore kur parashikohen realizimi i objektivave, si dhe planet e veprimit si instrumente në ndihmë të implementimit të vizionit. Rekomandohet të përfshihet në strategji strukturimi i departamentit në njësi mësimore/kërkimore.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Si në strategjinë institucionale si në dokumentin e studimit të tregut (Njësia bazë nuk ka një strategji zhvillimi) rëndësi merr rritja e vazhduar e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	

<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Bazuar në informacionin e marrë gjatë intervistave me grupet e aktorëve si dhe dokumenteve të vëna në dispozicion (plane mësimore, syllabuse dhe praktika procedurale) konkludohet se programi i studimit është sjellë konform bazës dhe përcaktimeve ligjore në fuqi.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit gjithashtu është konform kësaj baze duke indikuar qartë nivelin e kualifikimit që fitohet pas realizimit me sukses të programit.</p>
<p>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Universiteti ka prodhuar një draft-dokument strategjik i cili artikulon misionin, objektivat dhe mënyrat e realizimit të tyre të titulluar “Vizion 2020”.</p> <p>Rekomandohet të hartohet plani strategjik i njësisë bazë përgjegjëse (ose njësisë kryesore) për programin e studimit “Master i Shkencave në Arkitekturë”, në mënyrë që të artikulohet në mënyrë specifike oferta unike e këtij programi, si planifikohet përmirësimi i vazhduar i tij përmes proceseve akademike dhe kërkimore si dhe pikat e kontaktit me tregun e punës dhe aplikimit të profesionit.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Programi i studimit paraqitet i strukturuar në raport me kornizën ligjore dhe tenton të edukojë arkitektë të rinj si përgjigje ndaj nevojave të tregut lokal duke aspiruar të ofrojë një profil të ri arkitekti të orientuar drejt restaurimit arkeologjisë.</p> <p>Megjithatë në mungesë të një dokumenti strategjik mbetet i vështirë vlerësimi i pasqyrimin të misionit të IAL-së në programin e studimit, por mbi të gjitha duhet të reflektohet në mënyrë eksplicite se si gjen pasqyrim aspirata për një profil arkitekti në përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p><i>Rekomandohet</i> hartimi i dokumenteve strategjike në nivel njësie bazë/kryesore ku artikulohen vizionet dhe misioni i programit të studimit si dhe mënyrat e përmirësimit të vazhduar të tij</p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit /Departamentit përgjegjës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

SHLUJ UMB i ka të gjitha hallkat dhe njësitë akademike përmes të cilave strukturohen proceset didaktike dhe kërkimore. Njësitë bazë strukturohen në Fakultete, bashkësia e të cilëve, plus qendrat kërkimore formësojnë institucionin Pranë Rektoratit janë të atashuara një seri zyrash/njësish të cilat kryesisht fokusohen në mbarëvajtjen e proceseve didaktike e kërkimore. Senati akademik mbetet njësi më e lartë vendimmarrëse akademike, ndërsa bordi i administrimit për çështjet administrativo-ekonomike.

Siç përshkruhet në RVB-në e IAL-së, por edhe në Strategjinë e këtij të fundit, Universiteti ka në strukturën e tij dy fakultete, një akademi, katër institute dhe dy qendra kërkimore.

Referuar dokumenteve vënë në dispozicion, Fakultetet dhe Departamentet së bashku me institutet janë të renditura si vijon:

Fakulteti i Drejtësisë Shkencave Sociale e Politike

1. Departamenti i Drejtësisë
2. Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit
3. Departamenti i Shkencave Politike

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë:

1. Departamenti i Ekonomisë dhe Financës
2. Departamenti Biznes Menaxhim dhe Turizëm
3. Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike

Ndërkohë programi i studimit Msc (PI) në “Arkitekturë” nga Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike.

Megjithatë ka disa pika të cilat kërkojnë vëmendje; së pari atashimi i këtij programi studimi në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara; një praktike jo fort e hasur në edukimin në arkitekturë.

Katër institutet dhe dy qendrat kërkimore janë:

- Instituti i Edukimit Barleti (IEB)
- Instituti i Çështjeve Publike (AIPA)
- Instituti i Kërkim-Zhvillimit Barleti (BIRD)
- Instituti Adriapol
- Qendra Youth (ACT)
- Qendra e Trajnimit dhe Testimi Barleti (BTTC)

Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (Tabela 9 në aneks)

Fakulteti ka në organiken e tij 29 anëtarë personel akademik efektivë, si dhe 26 anëtarë, si personel akademik me kohë të pjesshme. Nga kategoria PAE, 4 anëtarë kanë titullin Profesor, 3 kanë titullin profesor i asocuar dhe 13 kanë gradën shkencore Doktor. Ndërkohë nga stafi me kohë të pjesshme 1 anëtar ka titullin profesor, 1 titullin profesor i asociuar dhe 8 kanë gradën shkencore Doktor.

Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike ka në përbërjen e tij 12 anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët: 1 Prof. Dr, 1 Prof i As dhe 3 Dr. Dekani i Fakultetit i përket kategorisë Profesor; Drejtuesi i Departamentit i ka gradën shkencore Doktor. Të gjithë anëtarët e Departamentit që i përkasin kategorisë Asistent/Lektor kanë kualifikimin Msc.

Stafi PAK pranë këtij departamenti është i përbërë nga 12 anëtarë, prej të cilëve 4 Dr.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Institucioni është i organizuar konform detyrimeve të kornizës ligjore; ai ka dy fakultete, katër institute dhe dy qendra, ndërkohë këto të fundit janë grupuara sipas dy drejtimeve kryesore në funksion të fushës së kompetencës; shkencave shoqërore dhe ato të aplikuara. Prezenca e instituteve dhe qendrave, edhe pse ende të pafunksionalizuara totalisht (sipas feedback-ut të marrë në terren) shihet pozitivisht në krijimin e pikave të kontaktit mes proceseve
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	

<p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>kërkimore dhe tregut apo aktoreve të tjerë.</p> <p>Çdo fakultet është i organizuar në tre njësi bazë, duke plotësuar detyrimin ligjor për ekzistencën e tyre.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë ku ofrohet ky program studimi është i organizuar në tre Departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Ekonomisë dhe Financës • Departamenti i Biznes, Menaxhim, Turizëm • Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike, <p>i cili është përgjegjës për programin në fjalë.</p> <p>Mbetet i diskutueshëm kompozimi i këtij Departamenti dhe asociimi i arkitekturës me shkencat kompjuterike; për sa kohe nuk ka ndonjë reflektim specifik në kurrikulën e programit të studimit.</p> <p>Një tjetër element që duhet theksuar është fakti që kategoria Profesor e asociuar pranë këtij departamenti në fakt nuk kontribuon në disiplina thelbësore të programit të studimit.</p> <p>Të dhënat e vëna në dispozicion ndaj grupit të vlerësuesve tregojnë një stabilitet të stafit të punësuar, gjithashtu demonstronjë politikë rekrutuese që tenton drejt personelit me grada e tituj shkencore. Ndërkohë përmes suportit që i jep stafit institucioni mbështet kualifikimin e vazhduar të tyre.</p> <p>Pavarësisht kësaj, duke iu referuar ngarkesës së stafit të brendshëm (jo asaj në terma sasiore por numrit të disiplinave që mbulon një pedagog) rekomandohet shtimi i numrit të personelit të kategorisë lektor.</p> <p>Po aq me rëndësi mbetet përfshirja e kategorisë Profesor në disiplina me rëndësi për programin e studimit, kjo nisur edhe nga specifikat që ka arkitektura dhe dizajni urban.</p>
--	--

Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Programi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë, përmes Departamentit të Arkitekturës dhe Shkencave kompjuterike. Nga vizita në institucion dhe kontakti i drejtpërdrejt me stafin e angazhuar të njësisë përgjegjëse për programin e studimit, si dhe autoritetet drejtuese mund të pohohet se njësitë janë të angazhuara maksimalisht dhe të ndërgjegjshme për nevojat dhe objektivat e programit të studimit.</p> <p>Nevojat për staf akademik evidentohen nga njësia bazë. Përmes thirrjeve të hapura për vende vakante pune, aplikantët vlerësohen përmes komisioneve <i>ad hoc</i> në nivel fakulteti e njësie baze.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Struktura hierarkike e institucionit është në përputhje me ligjin 80/2015.

Struktura e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë ka numrat e nevojshëm në terma të kapaciteteve akademike për të ofruar programe studimi.

Struktura e Departamentit të Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike ka numrat e nevojshëm në terma të kapaciteteve akademike për të ofruar programe studimi.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Referuar të dhënave të vena ne dispozicion, si dhe takimeve të drejtpërdrejta në institucion, SHLUJ Marin Barleti ka në përbërjen e tij një staf akademik i cili në terma numerike por edhe kualifikimesh përmbush detyrimet e vëna nga ligji 80/2015. Megjithatë, kjo panoramë e një analize në nivel institucional nuk gjen pasqyrim të plote nëse analiza bëhet në nivel programi studimi e nëse në fokus është programi i studimit, pra SHLUJ plotëson kushtet numerikisht, por për programin e studimit Msc (PI) në “Arkitekturë” ka mungese stafi ne disiplina thelbësore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Tabela 9 në aneks)

Departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave Kompjuterike ka në përbërjen e tij 12 anëtarë me kohë të plotë, nga të cilët: 1 Prof. Dr, 1 Prof i As dhe 3 Dr. Dekani i Fakultetit i përket kategorisë Profesor; Drejtuesi i Departamentit i ka gradën shkencore Doktor. Të gjithë anëtarët e Departamentit që i përkasin kategorisë Asistent/Lektor kanë kualifikimin Msc.

Stafi PAK pranë këtij departamenti është i përbërë nga 12 anëtarë, prej të cilëve 4 Dr.

- Të dhënat sipas kualifikimit te stafit dhe Raportet midis tyre (Tabelat 9 në aneks):

- Për vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 11 PAE (1 Prof/ 1 Prof.As/ 5 Dr/ 5 Msc) dhe 7 PAK (0 Prof/ 0 Prof.As/ 3 Dr/ 4 Msc)
- Për vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar 8 PAE (1 Prof/ 0 Prof.As/ 0 Dr/ 1 MND/ 6 Msc) dhe 15 PAK (0 Prof/0 Prof.As/ 5 Dr/ 10 Msc)
- Për vitin akademik 2016-2017 janë angazhuar 7 PAE (1 Prof/ 0 Prof.As/ 0 Dr/ 1 MND/ 5 Msc) dhe 13 PAK (0 Prof/ 0 Prof.As/ 2 Dr/ 11 Msc)
- Për vitin akademik 2015-2016 janë angazhuar 6 PAE (2 Prof/ 0 Prof.As/0 Dr/ 1 MND / 3 Msc) dhe 5 PAK (0 Prof/0 Prof.As/ 0 Dr/5 Msc)
- Për vitin akademik 2014-2015 janë angazhuar 6 PAE (2 Prof/ 0 Prof.As/ 0 Dr/ 1 MND / 3 Msc) dhe 2 PAK (0 Prof/ 0 Prof.As/ 0 Dr/ 2 Msc)

Nga analiza e mësipërme rezulton se:

- Për vitin akademik 2018-2019 janë angazhuar 61 % PAE dhe 39 % PAK

- Për vitin akademik 2017-2018 janë angazhuar 35 % PAE dhe 65 % PAK
- Për vitin akademik 2016-2017 janë angazhuar 54 % PAE dhe 46 % PAK
- Për vitin akademik 2015-2016 janë angazhuar 55 % PAE dhe 45 % PAK
- Për vitin akademik 2014-2015 janë angazhuar 75 % PAE dhe 25 % PAK

Referuar shifrave, në nivel Departamenti raportet e personelit që kanë grada dhe tituj duken pozitive, megjithatë, analiza në nivel programi studimi kërkon ende pasurimin e stafit të brendshëm me personel të kualifikuar e të lidhur me disiplinat specifike të Arkitekturës.

Në terma të numrit të përgjithshëm të stafit të angazhuar sipas viteve, qofte efektiv apo me kontratë, vërehet rritje e numrit të totalit të tyre. Ndërkohë sipas përqindjeve, vërehet që **ngarkesa mësimore ne kredite** mbulohet nga stafi efektiv, në raportet 70-85 % përkundrejt stafit PAK, përveç viteve 2016-2017 dhe 2017-2018 kur kanë dominuar në shifra më pak se 70% të stafit efektiv.

Është për tu theksuar rritja e përqindjes së stafit me gradën shkencore Doktor, qofte i kategorisë PAE qofte i asaj PAK. Kjo ka ardhur si rezultat i politikave të rekrutimit, si dhe kualifikimit të vazhduar të stafit të angazhuar.

- Të dhënat sipas seksit/moshës së personelit (Tabela 5 dhe 6 në aneks)

Shifrat tregojnë raporte të balancuara lidhur me çështjet e barazisë gjinore. Ndërkohë pozitiv shihet fakti i përbërjes në masë të personelit akademik me staf të ri në moshë, e që demonstroi tendencë të vazhduar për kualifikim.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit (Tabela 2 në aneks)

Këshilli i programit të studimit është i kryesuar nga Drejtuesi i Departamentit i cili ka gradën shkencore Doktor, një anëtar i kategorisë Lektor si dhe një i kategorisë asistent-lektor.

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Përmes kontakteve me zyrën e burimeve njerëzore si dhe njohjen me modelet e kontratave të përdorura në lidhje me punësimin e stafit, mund të thuhet se personeli i pajtuar njihet që në fillim me detyrimet dhe të drejtat e tij. Një aspekt pozitiv e që nxiti rritjen e kapaciteteve akademike të stafit janë disa përcaktime në kontratë të cilat lidhen me një numër publikimesh e pjesëmarrjesh në aktivitete shkencore të detyruara nga ana e personelit, për çdo vit akademik.

- Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmës akademik paraqitet i angazhuar e përgjegjës për detyrimet që ka në lidhje me përmbushjen e objektivave e vizioneve të programit të studimit.


- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- [Ngarkesa për tre vitet e fundit.pdf](#)
- [Lendet sipas stafit akademik për gjithë periudhën.pdf](#)
- [Lista e stafit akademik në program në vite.pdf](#)
- [Kontrate pune PAE.pdf](#)
- [Kontrate pune PAK.pdf](#)
- [Tabela me temat e diplomës për student dhe pedagoget udheheqes.pdf](#)
- [Vendimi \(minutës\) për ndarjen e ngarkesës në departament.pdf](#)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Nga vizita në institucion , përmes kontakteve të drejtpërdrejta me stafin dhe studentët vërehet se angazhimi i stafit akademik dhe ndihmës-akademik është i plotë në lidhje me nevojat e programit të studimit.</p> <p>Në funksion të performancës një pjese e tyre ka angazhim në disa procese në përputhje me nevojat e programit të studimit. Zyra e karrierës dhe alumni, sekretaria, koordinatori i programit zyra e burimeve njerëzore apo e cilësisë paraqesin tablonë e një stafi të angazhuar për mbarëvajtjen e proceseve mësimore dhe kërkimore.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Nga dokumentacioni mbi procedurat dhe funksionimin e njësisë bazë mund të thuhet që kjo e fundit inicion proceset kryesore të përditësimit dhe përmbajtjes së programit të studimit.</p> <p>Ndarja e ngarkesës bëhet nga përgjegjësi i departamentit në fillim të vitit akademik. Ngarkesa vjetore e një personeli akademik efektiv mesatarisht është 350 ore vjetore ose 17-18 orë mësimi në javë.</p> <p>Nga tabelat e vëna në dispozicion vërehet angazhim i stafit në shume disiplina. Gjykuar nga CV-të e tyre rekomandohet shtimi i kategorisë lektor, me synim uljen e angazhimit në disa disiplina.</p> <p>Gjithashtu kjo do të sillte edhe uljen e sasisë së orëve në auditor, faktor që do të çonte fokusim dhe përmirësim të performancës së lektorit në auditor.</p> <p>Praktika e rekrutimit të stafit nis që nga Departamenti duke ndjekur hapat konform kuadrin ligjor.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Zyra e burimeve njerëzore është përgjegjëse e ndjekjes së procedurave për rekrutimin e stafit me kohë të plotë e të pjeshme. Në çdo rast, është Departamenti i cili evidenton nevojat dhe përcjell propozimin për vendin vakant të punës. Sipas kontratave tip të vëna në dispozicion, vendi vakant shoqërohet me kriteret, ngarkesën dhe disiplinën ku do të angazhohet stafi. Në kontratat me kohë të plotë, nuk specifikohet disiplina ku angazhohet personeli i punësuar.</p> <p>Ngarkesa e mbuluar nga stafi i jashtëm është rreth 850 orë. Nga 3000 ore në total të prodhuara nga programi i studimit, është rreth 1/3 e ngarkesës se orëve në auditor.</p> <p>Raporti numerik staf i brendshëm/staf i jashtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për vitin akademik 2018-2019 është 11/7 pra 61% / 39% - për vitin akademik 2017-2018 është 8/15 pra 35 % / 65 % - për vitin akademik 2016 -2017 është 7/13 pra 54 % / 46 %

Oliver



	<ul style="list-style-type: none"> - për vitin akademik 2015-2016 është 6/5 pra 55 % / 45 % - për vitin akademik 2014-2015 është 6/2 pra 75 % / 25 % <p>Përsa i përket ngarkesës mësimore në kredite /orë mësimore, referuar Tabelave 9, rezultojnë këto të dhëna:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 2018-2019 staf i brendshëm 71.3 % të ngarkesës/staf i jashtëm 28.7 % të ngarkesës mësimore - 2017-2018 staf i brendshëm 51.3 % të ngarkesës/staf i jashtëm 48.7 % të ngarkesës mësimore - 2016-2017 staf i brendshëm 63.9 % të ngarkesës/staf i jashtëm 36.1 % të ngarkesës mësimore
	<ul style="list-style-type: none"> - 2015-2016 staf i brendshëm 77.5 % të ngarkesës/staf i jashtëm 22.5 % të ngarkesës mësimore - 2014-2015 staf i brendshëm 85 % të ngarkesës/staf i jashtëm 15 % të ngarkesës mësimore <p>Referuar pasqyrës se mësipërme të shpërndarjes se ngarkesës ndër vite mes stafit efektiv dhe atij te ftuar vërehet një shpërndarje konform kornizës së ligjit 80/2015 ku rreth 70-75% e ngarkesës përballohet nga stafi i brendshëm. Përrjashtim kanë bërë vitet 2017-2018 dhe 2016-2017 ku ka marrë peshë ngarkesa e stafit të ftuar.</p>
	<p>Dosjet e stafit akademik janë të depozituara pranë zyrës se burimeve njerëzore.</p> <p>Po kjo zyre posedon edhe një <i>database</i> që lidhet me performancën akademike të stafit, e cila nuk është vene në dispozicion. Rekomandohet të shtohet në dokumentacion një formë e cila dokumenton dhe gjurmon ritjen akademike të stafit.</p>

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të ftuar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e</p>	<p>Drejtuuesi i Departamentit mban gradën shkencore Doktor.</p> <p>Titullarët e lëndëve në vitet e 4 dhe 5 rekomandohet të jenë me gradën doktor.</p> <p>Autoritetet drejtuese të Fakultetit rezultojnë të jenë të punësuar me kohë të plotë dhe janë konform ligjit me titujt shkencore dhe kategorisë profesor.</p> <p>Drejtuuesit e lëndëve dhe syllabuseve janë të gradës Doktor apo kanë kualifikimin Master i Shkencave. Për të siguruar mbulimin e lëndëve me staf të kategorisë lektor janë dubluar në disa lende stafi udhëheqës, fakt që çon në mbingarkesën e personelit me kohë të plotë.</p> <p>Sipas dokumentit të vënë në dispozicion praktika profesionale konsiderohet pune individuale e studentit. Ndërkohë nga kontaktet me stafin pohohet se inkurajohet atashimi i studenteve në studiot apo atelietë e arkitekturës me qëllim kontaktin direkt me profesionin.</p>
---	---

praktikave profesionale.	
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, i cili pasqyron shpërndarjen e diplomanteve, temave dhe udhëheqësve vërehet se çdo student i nivelit master ka një udhëheqës shkencor për tezën e tij ose dy të tillë, ku një është i huaj. Bashkëpunimi me PoliBA në projektet Erasmus+ ka sjelle impakt pozitiv në përfshirjen e stafit të huaj në udhëheqjen e tezave.</p> <p>Supervizori shkencor i tezës ka gradën shkencore Doktor, në të gjitha rastet referuar tabelës së vënë në dispozicion. Edhe në rastet kur është Msc, është dubluar nga një staf me gradën shkencore Doktor.</p> <p>Në total për vitin 2018-2019 janë 14 studente diplomante, dhe në çdo rast asnjë supervisor i tezës nuk udhëheq me tepër se 10 studentë.</p>
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Referuar profileve të udhëheqësve në dokumentacionin vënë në dispozicion, fushat e tyre të kërkimit përputhen me natyrën e diplomave dhe tezave kërkimore në Arkitekture.</p> <p>Rekomandohet të shtohet në dokumentacion edhe CV-te e stafit që angazhohet në procesin e diplomave nga PoliBA.</p>
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Në infrastrukturën fizike të fakultetit përfshihet një laborator dedikuar lëndëve me karakter grafik, si dhe atelie pune për lëndët me karakter projektual. Staf i ndihmës (rekomandohet të cilësohet në dokumentacion nëse ka IT etj) duket i angazhuar në mbarëvajtjen e proceseve lidhur me këto ambiente.</p> <p>Përmes normimit të punës dhe kontributit akademik/institucional dhe specifikimit të detyrave për çdo personel ndihmës apo akademik, lexohet një politike e balancuar e institucionit në menaxhimin e resurseve njerëzore.</p>
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Shpërndarja e ngarkesës së stafit akademik bëhet në përputhje me përcaktimet e VKM-së nr. 29 të datës 10.09.2018 Referuar këtij dokumenti ngarkesa javore e një personeli akademik me kohë të plotë duhet të jetë maksimalisht rreth 16-20 orë në javë.</p> <p>Ngarkesa vjetore mesatare e një pedagogu të brendshëm, duke iu referuar dokumenteve të vena në dispozicion, si tabela e shpërndarjes pedagog/lende/ngarkese vjetore vërehet se ngarkesa vjetore luhet në vlerat 300-350 ore.</p> <p>E përlllogaritur në ngarkese javore varion në 15-17 ore të tilla në auditor.</p> <p>Duke iu referuar syllabuseve të vitit 2018-2019 dhe vizitës në institucion, konstatohet se 3 pedagogë të brendshëm mbulojnë nga 6</p>

	lëndë, 2 mbulojnë nga 5 lëndë, 1 mbulon 4 lëndë dhe të tjerët nga 1 lëndë.
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e pl</p> <p>otë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Zyra e burimeve njerëzore posedon dokumentacionin ligjor të nevojshëm për stafin e angazhuar me kohe të plote, të pjesshme, akademik apo ndihmës-akademik pranë universitetit.</p> <p>Rekomandohet të vihet në dispozicion një dosje tip e performancës akademike vjetore të një personeli akademik me kohe të plotë/pjesshme</p> <p>Sipas kontakteve me stafin në vizitën e realizuar u pohua se thirrja bëhet publike me kriteret dhe nevojat e përcaktuara nga Departamenti, i cili identifikon mungesat në staf.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Struktura e stafit aktual paraqitet e mirë-kompozuar, me individë të angazhuar e që demonstrojnë kapacitete e kompetencën e duhur për natyrën e programit të ofruar. Procedurat e seleksionimit synojnë drejt rekrutimit të individëve kualitativë.</p> <p>Mosha e re e stafit është një e dhënë pozitive, sepse lidhet me përpjekjen e vazhduar të këtij të fundit për t'u kualifikuar.</p> <p>Nga ana tjetër, paraqitet një nevojë për staf të kategorisë profesor që kontribuon në disiplina thelbësore të programit të studimit.</p> <p><i>Rekomandim:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Rritja e numrit të stafit të kategorisë lektor me synim uljen e ngarkesës vjetore të stafit aktual si dhe uljen e numrit të disiplinave që çdo anëtar jep. Kjo do të shkonte në favor të rritjes së cilësisë.</i> 	

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, rezidencat.

Një nga çështjet dhe aspektet më me rëndësi në edukimin në arkitekturë mbetet infrastruktura fizike, kjo lidhur me kërkesat specifike që proceset didaktike e kërkimore kanë në këtë fushë. Së pari është me shumë rëndësi që ambientet fizike të jenë të mjaftueshme në terma sasiore (referuar standardeve evropiane, shpesh herë vlerat variojnë në 7.5-8 m²/student) por edhe në terma cilësorë.

Ka një kategori hapësirash, ku zhvillohen labororët e projektimit apo atelietë, të cilat parashikojnë mobilim specifik, apo edhe pajisje specifike për zhvillimin e modeleve 2 apo 3 dimensionale. Po aq vlerë kanë labororët e komunikimit grafik si dhe biblioteka. Shpesh here programet janë të pajisura me një seri shtesë labororësh; duke filluar nga ata të fizikës teknike, akustikës, materioteka etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit (Tabela 11 ne Aneks)

Referuar të dhënave të Tabelës 11 në Aneks, por edhe vizitës në institucion ambientet për programin e studimit në terma sasiore, te pa diferencuar në zëra janë rreth 7 m² / student. Ndërkohë që zëra me rëndësi për proceset didaktike si laboratorë, klasa etj janë ne total rreth 3655.5 m². Pjesa ndihmëse është rreth 3545.6 m². Zëri i laboratorëve për lëndet është rreth 217 m², dhe nëse do të interpretohej në m²/student do të kishim një raport prej 2.85 m² për çdo të tillë. Në këtë sens, do të rekomandohej shtimi i zërit për ambiente dedikuar proceseve relevante didaktike të programit të studimit.

Sipas të dhënave të Tabelës 11, në finalizim të të gjitha të dhënave metrike të tabelës me zërat e sipërm del një sipërfaqe rreth 7 m²/student.

Mjediset për stafin (Tabela 11 ne aneks):

Po sipas tabelës së vënë në dispozicion, si edhe vizitës në institucion, mund të pohohet një infrastrukture fizike që plotëson standardet në terma të sasiore por edhe cilësore.

Në finalizim të të gjitha të dhënave metrike të tabelës me zërat e sipërm del një sipërfaqe rreth 15 m²/ punonjës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Aktiviteti akademik dhe kërkimor i këtij institucioni zhvillohet në dy qendra të pozicionuara në pika të ndryshme të qytetit. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë është i pozicionuar në një kompleks ndërtesash të përshtatura për funksione didaktike pranë qendrës së qytetit.</p> <p>Nga kontaktet me stafin mësohet se këto ambiente posedohen nga institucioni dhe janë në përdorim deri në ndërtimin e <i>kampusit</i> të ri.</p> <p>Ambientet didaktike janë të mbledhura kryesisht në një godinë, ndërkohë ato administrative në një tjetër. Distanca është e vogël dhe e menaxhueshme.</p> <p>Në terma të standardeve fizike të ambienteve, si cilësia e hapësirave qarkulluese, dimensionet e klasave, ndriçimi, lagështia e ventilimi vërehen disa mangësi të cilat kryesisht derivojnë prej faktit që ndërtesa është adoptuar.</p> <p>Numri relativisht i vogël i grupeve mësimore e zbut këtë fakt, por duhet theksuar që hapësira me dimensione të konsiderueshme rezervuar për atelie, salla të përpunimit të maketeve dhe modeleve mungojnë.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të</p>	<p>SHLUJ MB ka një bibliotekë në nivel IAL-je. Nga vizita në terren dhe takimet me punonjësit e bibliotekës u vu re një infrastrukturë fizike relativisht modeste.</p> <p>Tekstet e dedikuara programit të studimit paraqiten të kufizuara në numër, ku literatura shqip është mbizotëruese. Literatura baze për edukimin në arkitekture nuk paraqitet e</p>

<p>studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>plotë.</p> <p>Informimi përmes mjeteve digjitale kryesisht bazohet në platformat e hapura dhe rrjetet globale të kërkimit (research). Nuk u përmend ndonjë strategji konkrete për pasurimin e bibliotekës dhe përditësimin e titujve.</p> <p>Libraria qëndron e hapur në mënyrë konstante (8.00-17.00) dhe është hapësirë në dispozicion të studenteve, konform orarit të tyre mësimor</p>
---	---

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion, ky i fundit ka në infrastrukturën e tij fizike një laborator të pajisur me kompjuterë ku zhvillohen lëndët me karakter grafik.</p> <p>Numri i kompjuterëve është i mjaftueshëm për madhësinë e grupeve mësimore dhe ofrojnë programet baze për nocionet e komunikimit grafik digjital</p> <p>Ambientet e tjera dedikuar proceseve didaktike si salla seminaresh apo leksionesh paraqiten të mobiluara dhe të pajisura me elemente që mundësojnë projeksionet audiovizuale dhe një komunikim normal mes pedagogut e studentit.</p> <p>Gjithashtu institucioni posedon një hapësirë/atelier e cila është në dispozicion të studenteve për pune individuale të tyre, përgatitje modelesh apo projektesh.</p> <p>Ndërkohë në RVB përmenden në formë tabelore salla dedikuar laboratorëve, por të para në rang fakulteti, duke bere të vështirë leximin në rang programi studimi.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Infrastruktura fizike paraqitet si pika me problematike, kjo lidhur me specifikat që ka arkitektura si disipline dhe nevojat e veçanta për hapësira në terma sasiore dhe cilësore.

Faktor principal që shkakton vështirësi infrastrukturore është fakti që ndërtesa aktuale është e përshtatur për ambiente didaktike, duke bere që një kategori hapësirash të jenë jo konform standardeve.

Rekomandime:

- Të përmirësohet gjendja e botimeve lidhur me programin e studimit në bibliotekën e universitetit
- Të përmirësohen në terma fizike e në nivel mobilimi ambientet dedikuar laboratorëve të projektimit

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

SHLUJ Marin Barleti është shoqëri tregtare. Referuar të dhënave të paraqitura në formë tabelore në RVB-në e institucionit (Tabela 10 në aneks) për katër vitet e fundit, vërehet se burimet kryesore të financimit janë të ardhurat e studenteve, konsulencat dhe shërbimet trajnuese. Sipas deklaratimit të këtij raporti, kostoja për një

student është e përlogaritur në 1250 euro/vit. Për sa i takon strukturimit administrativ, duket se institucioni i ka të gjitha hallkat të cilat janë përgjegjëse për mbarëvajtjen financiare të institucionit, si Administratori, Përgjegjësi i Financës dhe Financieri.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim 0 %
- Konsulencat, shërbimet 1 %
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit 97.5 %
- Shërbimet trajnuese (kualifikimi i vazhdueshëm) 1.1 %
- Sponsorizimet, donacionet, aktiv siguroese, fondacione 0 %
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, rezidencat, etj) 0.4 %

Siç përmendet edhe në paragrafin e mësipërm, duke iu referuar të dhënave të paraqitura në trajtë përqindjesh vjetore në tabelën nr 10 te aneksit, për katër vitet e fundit, vërehet se burimet kryesore të financimit janë të ardhurat e studenteve, konsulencat dhe shërbimet trajnuese.

Në këtë mënyrë dhe shpenzimet kryesore lidhen me mbulimin e kostove fikse dhe kostove që prodhojnë programet e studimit si ajo e studentit, infrastruktura, investimet në logjistike etj.

Gjatë të katër viteve të deklaruara zëri i grantit për kërkim shkencor është zero. Ndërkohë vërehet ulje e zërit të shërbimeve për konsulencë dhe rritje e të ardhurave nga tarifat e studentëve. Ndërkohë në formulimin e buxheteve, rekomandohet të ndiqet një politikë e cila favorizon shpenzime edhe për kërkimin shkencor.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Sipas deklaratimit të këtij raporti, kostoja për një student është e përlogaritur në 1250 euro/vit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Të dhënat kryesore mbi vlerësimin e këtyre kriterëve bazohen në RVB (Tabela 10 në Aneks) e prodhuar nga institucioni.</p> <p>Perceptohet që zëri kryesor i të ardhurave mbeten tarifat e studenteve. Megjithatë analiza duket e kryer në rang institucional e jo në nivel programi studimi.</p> <p>Një analizë e tillë do të sillte një panoramë më të qartë të koston së studentit.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të</p>	<p>Gjykuar kryesisht mbi të dhënat e RVB-së dhe takimeve me stafin mund të thuhet se institucioni paraqet një gjendje të stabilizuar financiarisht.</p> <p>Edhe nga takimet me stafin perceptohet një politike e hartimit</p>

studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

të buxhetit e cila fokusohet tek stafi, dhe investimet në infrastrukturë me fokus studentin.

Konkluzionet e vlerësimit:

SHLUJ UMB paraqet një gjendje të stabilizuar financiare. Rekomandohet një analizë më e detajuar në nivel programi studimi, e cila jep një kosto më të përafëruar të studentit të arkitekturës. Një analizë e tillë do të ndikonte në përpilimin me real të buxheteve.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

SHLUJ Marin Barleti demonstroi seriozitetin institucional në përballjen me çështjet e cilësisë së programeve të studimit që ofron, por edhe të aspekteve të tjera që direkt apo indirekt ndikojnë në këtë fushe.

Sistemi i matjes së cilësisë është i institucionalizuar përmes njësisë së SBC dhe Zyrës së Kurrikulës. Nga ana tjetër një seri praktikash të cilat tentojnë të koordinojnë punën mes hallkave drejtuese akademike e administrative synojnë në ngritjen e cilësisë dhe performancës së institucionit. (Të dhëna për anëtarët e ZZHKC - Tabela 8)

Sistemi i cilësisë në mësimdhënie bëhet në rang institucioni; ku çdo student bëhet pjesë e një pyetësori me ane të se cilit vlerëson lenden dhe mënyrën e mësimdhënies. Rezultate të matshme të këtyre anketimeve nuk janë shumë të qarta, pasi vete specifika e disiplinës së arkitekturës kërkon e departamenti të ketë një rol të drejtpërdrejtë në vlerësimin e mësimdhënies dhe zhvillimin e metodave vlerësuese për departamentin e arkitekturës. Ky departament ka specifika komplekse të ndryshme nga departamentet e tjera. Duke iu referuar dokumentit “Raport në lidhje me Vlerësimin e Studentëve për Lëndët e semestrit të parë në programet Bachelor 2018-2019”, vihet re që studentet e departamentit të Arkitekturës nuk kanë një pjesëmarrje të mjaftueshme për t’u marrë si term reference në vlerësimin e brendshëm të mësimdhënies. Për këtë, sugjerohet të aplikohen metoda të qenësishme.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët
- Sa studentë janë anketuar
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm, etj

Sipas të dhënave në dokumentet e vëna në dispozicion, por edhe sipas takimeve me personelin përgjegjës të njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, anketimi i studenteve kryhet 2 herë në vit, përpara periudhës së sezonit të provimeve.

Në fakt për programin e studimit në Arkitekturë vetëm 2 studente kanë plotësuar pyetësozin. Siç edhe përshkruhet nga takimet me stafin, të dhënat e pyetësozit diskutohen me pedagogoet individualisht (kur problemet lidhen me ta) dhe behën objekt i diskutimeve të Senatit Akademik kur feedback-u i të dhënave lidhet me programet e studimit.

Mungon informacioni si u përcillen të dhënat fakulteteve e departamenteve dhe si reflektohet mbi ato të pyetësorëve në terma të masave të marra.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i cilësisë kryhet nga njësia përgjegjëse dhe instrumentet përfshijnë formën e raportimit dhe koordinimit të punës së njësisë të tjera akademike apo administrative

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Mungon një procedurë që mundëson komunikimin mes qendrës së cilësisë dhe planit të masave të veprimit që merren nga departamentet apo njësite kryesore.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Institucioni ka përpiluar një Raport të Vlerësimit të Brendshëm, i cili ka arritur të evidentojë aspektet pozitive, pikat e dobëta, risqet dhe oportunitetet e programit të studimit.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Ne hartimin e strategjisë së njësisë baze, është e rekomanduar të përfshihen mekanizmat përmes të cilëve sigurohet marrja e masave për problemet që dalin nga observimet e vetëvlerësimeve periodike.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- [Procedura e përmirësimit të planit mesimor.pdf](#)
- [Procedura e përmirësimit të syllabuseve.pdf](#)
- [Menyra e vlerësimit të stafit, paragraf shpjegues dhe modelet e tabelave dhe skedave të vlerësimit.pdf](#)
- [Vlerësimi i studenteve për një semester për programin e arkitektures.pdf](#)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none">a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;c. Pyetje konceptuale;	<p>Institucioni ka vendosur në dispozicion dy instrumente kryesore përmes të cilëve monitoron dhe vlerëson cilësinë e programit të studimit e komponentëve të tij;</p> <p>Një raport vjetor, i cili shprehet në rang institucioni si dhe pyetësorë të realizuar periodikisht çdo semestër, përpara sezonit të provimeve (2 here në vit) për studentet.</p> <p>Të dhënat e pyetësorit i adresohen Rektorit dhe janë objekt i diskutimit të Senatit, kjo referuar RVB-së. Nuk ka praktike e cila dëshmon publikimin e të dhënave të këtyre pyetësorëve. Ndërkohë të dhënat u komunikohen individualisht pedagogeve.</p> <p>Nga observimi i dokumentacionit vërehet pjesëmarrje e ulët e studenteve në pyetësor; kjo sepse formati nuk është i detyrueshëm.</p>

<p>d. Intervista;</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p>	<p>Në RVB përmendet zyra e zhvillimit të kurrikulave dhe komisioni i sigurimit të cilësisë, si ente të cilat kanë për detyrë monitorimin dhe angazhimin për përmirësimin e elementeve të programit të studimit dhe cilësisë në përgjithësi.</p> <p>Nuk paraqiten praktika të tjera të cilat konsiderojnë vlerësimin e performancës së stafit dhe autoriteteve drejtuese. Nga kontakti me përfaqësues të qendrës së cilësisë me tepër sesa përpilimi i raporteve koordinimi i punës së njësive siguron cilësinë. Rekomandohet të atashohet një praktike e cila demonstroi se si nxitet departamenti të përditësojë/përmirësojë kurrikulën; si nxitet inkurajohet stafi të përmirësojë performancën; Si nxitet/inkurajohet kërkimi shkencor. Ndërkohë nuk është vënë në dispozicion një raport vjetor i punës kërkimore/mësimore i Departamentit. Po ashtu një agjende vjetore apo një plan-veprimi për të përmirësuar problemet e evidentuara nga raporti vjetor.</p>
---	--

Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.

<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p>	<p>Nuk është vënë në dispozicion broshure apo material promovues lidhur me proceset e sigurimit të cilësisë, përveç se raportit vjetor në rang institucioni</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Nuk është vënë në dispozicion <i>link</i> apo një adrese ku publikohen të dhënat e vlerësimit të brendshëm.</p>

Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p>	<p>Përveç një raporti në terma institucionale i cili përpilohet nga Rektori, nuk ka një praktike e cila analizon në periudha vjetore programet e studimit.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Politikat e përmirësimit të programit të studimit duhet të inkuadrohen në strategjinë e njësive bazë</p>

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Programi akreditohet për here të parë</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p>	<p>Instrumentet kryesore përmes të cilave sigurohet cilësia janë Raportimi vjetor dhe Pyetësorët periodike.</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p>	<p>Rekomandohen planet e veprimit, trajnimet dhe analizat në nivel njësie-bazë, të lidhura drejtpërdrejt me programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p>	<p>Zyra e kurrikulave duhet të evidentojë rëndësinë e grupeve mësimore si hallka kryesore e sigurimit të cilësisë së syllabuseve, analizave të grup-lendeve dhe kurrikulës në përgjithësi.</p>
<p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p>	<p>Nga takimi me stafin përkatës mund të konkludohet se institucioni impenjohet në rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të stafit mbi rëndësinë e proceseve të sigurimit të cilësisë</p>
<p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Rekomandohet përpilimi i një dokumenti të unifikuar e publik</p>

në të cilin sqarohen strategjitë, politikat si dhe procedurat përmes të cilave sigurohet cilësia e programit të studimit.

Konkluzionet e vlerësimit:

SHLUJ UMB ka një sistem të vlerësimit të cilësisë relativisht funksional, i cili tenton të integrojë punën e disa njësive me detyra e kompetenca të ndara. Instrumentet kryesore përmes të cilave monitorohet ecuria dhe cilësia e përbushjes së programit të studimit janë një Raport vjetor i zhvilluar në nivel institucional dhe sistemi i pyetësorëve të studentëve.

Rekomandohet që:

- *njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit të përpilojë raport vjetor të punës didaktike dhe kërkimore.*
- *strukturimi i departamentit në grupe mësimore të cilat janë përgjegjëse për të gjitha nivelet e analizave që bëhen në nivel lënde, grup-lëndësh apo edhe kurrikulës në tërësi.*
- *të përpilohet një metodologji e cila e bën plotësimin e pyetësorit të detyrueshëm për studentin, me synim rritjen e përqindjes së pjesëmarrjes së tyre dhe të krijuarit të një opinioni me të qëndrueshëm lidhur me performancën e stafit në auditor.*

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit i ciklit të dyte (300 kredite) Master i Shkencave (Program i Integruar) në “Arkitekturë” ka si synim formimin e profesionisteve të kualifikuar në fushën e arkitekturës në përgjigje të kërkesave bashkëkohore.


SHLUJ UMB ka përcaktuar misionin dhe objektivat e programit të studimit, përmbajtjen e programit dhe rregulloren e programit. Gjithashtu në dokumentacionin e paraqitur dhe nga rezultatet e vizitës në institucion rezulton se organizimi i vitit mësimor, semestrave, planeve mësimore me të gjithë komponentët e tij (modul, kritere, përcaktimi i orëve brenda dhe jashtë auditori) janë të mirë paraqitura. Lendet janë të gjitha të pajisura me syllabuset përkatës ku janë shprehur qartazi nevojat dhe kriteret që formulojnë modulin.

Gjate takimit me drejtuesit e departamentit u diskutua edhe për një adoptim të kurrikulës me një profilizim në “arkitekture arkeologjike”. Kjo përshtatje kërkon të bazohet në një studim tregu dhe të këtë një përditësim në misionin dhe objektivat e programit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi ka filluar aktivitetin në vitin akademik 2014-2015 me 12 studente në total. Qëllimi dhe objektivi i këtij programi është i parashtruar në rregulloren e tij.



Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Ky program është i organizuar në formën e studimeve me kohe të plote, me kohëzgjatje 5 vite akademike dhe me një total prej 300 ECTS.

- 1 ECTS 25 ore mësimore pune të studentit
- 1 ore mësimore 50'
- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabelat 7 në Aneks)

Programi i studimit i ciklit të dyte Master i Shkencave (Program i Integruar) në "Arkitekturë" përmban 37 lende të organizuara në 46 module, me një total prej 300 ECTS ku përfshihet praktika profesionale, punimi i diplomës dhe 2 lende me zgjedhje, e organizuar në 2 module secila me një total prej 9 ECTS.

Studentet përmbushin kërkesat për të marre diplomën "Diplome e Integruar Master i Shkencave në Arkitekturë" nëse i plotësojnë 300 kredite ECTS.

GVJ e gjen kurrikulën në përputhje me kërkesat dhe objektivat e programit, se bashku me peshën specifike që ka secila lende/modul.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 7.5 orë në auditor dhe 17.5 orë punë e pavarur e studentit
- Provim përf/Punimi i Diplomës 10 orë në auditor dhe 15 orë punë e pavarur e studentit

Ndarja dhe përcaktimi i krediteve për leksione, seminare dhe praktika profesionale është e përshtatshme dhe në përputhje me udhëzimet e ligjit për këtë qëllim. Ndërkohë nuk ka evidenca se si bëhet kjo ndarje për lendet me laborator dhe është e paqartë se si shprehet në orar ngarkesa në auditor e diplomës.

Bazuar zbërthimit të kreditit në planin mësimor, punimi i Diplomës ka mbingarkese të orëve në auditor (300 orë në semestër /15 jave= 20 ore në auditor).

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licencuara

Ky është akreditimi i pare i këtij programi dhe nuk vihet re ndryshim në planet mësimore në këtë 5 vjeçar.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela 9 në Aneks)

Nga të dhënat e paraqitura në lidhje me personelin akademik të angazhuar në këtë program studimi për vitin akademik 2018-2019 rezulton se përbëhet nga 11 pedagogë PAE dhe 7 pedagoge PAK, nga të cilët për PAE: 1 Prof. Dr, 1 Prof. As. Dr., 4 Dr. dhe 5 Msc. Nga këta: 7 lektore janë nga departamenti i Arkitekturës dhe Shkencave kompjuterike dhe 2 kanë titullin Dr. shkencash. Për sa i përket PAK, kualifikimi i tyre është: 3 Dr. dhe 4 Msc.

Raporti staf efektiv/staf me kontrate është 61 % / 39 %.

Referuar CV-ve të stafit akademik, të vena në dispozicion të GVJ mund të konkludohet se të gjithë janë të kualifikuar në fushën e arkitekturës, fakt ky që i kthen në profile të përshtatshme për tu angazhuar në një program studimi të tillë. Referuar po CV-ve të stafit, vërehet që një anëtar është i angazhuar mesatarisht në 3-4

lende, shpesh herë edhe të natyrave të ndryshme si p.sh., teknologji arkitekture, gjeometri deskriptive dhe laborator projektimi. Kjo vjen si pasojë e tendencës për të mbuluar me personel akademik me gradë Dr, sidomos lëndët e viteve të katërta e të pesta.

Duke u bazuar në dokumentacionin e marrë gjatë vizitës në institucion, vërehen disa mospërputhje të udhëheqësit të lendes/modulit të paraqitur në tabelën e pedagog-lëndë me atë që është shprehur në syllabus.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Nga vëzhgimi i syllabuseve të vëna në dispozicion ato janë të strukturuar sipas shtojcës së VKM-së nr. 41 dhe më specifikisht sipas zërave të mëposhtëm:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetësimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset e depozituara si pjesë e Dosjes së Vetëvlerësimit janë të gjitha të hartuara sipas të njëjtit format dhe përmbajnë të gjithë elementet e lartpërmendur. Në përmbajtjen e tyre përcaktohen qartë objektivat e modulit që janë në përputhje me objektivat e programit të studimit. Temat që trajtohen janë bashkëkohore dhe formuese për studentet e arkitekturës. Metodologjia e mësimdhënies është gjithashtu e larmishme dhe në përputhje me objektivin e secilës lëndë.

Gjatë takimeve në institucion, stafi akademik dhe studentet konfirmuan që syllabuset hartohen nga udhëheqësit e lëndëve dhe me pas miratohen në departament dhe fakultet. Studentet njihen që në fillim të semestrit me syllabuset e lendeve dhe janë në dijeni të përmbajtjes së lëndës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Shuma e kredive të grumbulluara gjatë vitit nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 ECTS. Për një periudhë 5 vjeçare, nevojiten gjithsej 300 ECTS
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Programi i studimit është në përputhje me misionin e Institucionit.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukura" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;	Departamenti i Arkitekturës dhe i Shkencave Kompjuterike, u ofron studentëve njohuri të thella, kompetenca shkencore teorike dhe praktike, dhe trajnime shkencore kërkimore. Pas diplomimit studentët janë të gatshëm të ushtrorjnë profesionin dhe të plotësojnë kriteret e nevojshme për një licencë
Kriteri 3 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukura" dhe "Master Profesional"	

<p>synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>profesionale sipas ligjit në fuqi.</p> <p>Programet e Integruara të Ciklit të Dytë në Arkitekturë mund të shkojnë më tej për të qenë të punësuar në fusha të ndryshme profesionale në sektorin privat dhe publik</p> <p>Deri në fund të studimeve, studentët kanë përfunduar me sukses së paku 300 ECTS. Të gjitha këto të dhëna janë tregues se ky program studimi shkon në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit</p>
---	--

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.

<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Bazuar në plan-program dhe në programet e lëndëve relevante, përmbajtja dhe rendi i objektivave të programit të studimit synojnë arritjen e synimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilat ofrohen. Çdo Lende ka objektivat e veta të caktuara.</p> <p>Format e vlerësimit të studentëve shprehen qartë në programet e çdo lënde. Këto mund të jenë: projekte, detyra kursi, pjesëmarrje në mësim, seminare/ ushtrime.</p> <p>Në aspektin metodologjik, komponentët e vlerësimit ndahen në peshë në përqindje, e shprehur kjo në syllabuset e lëndëve. Konkretisht pjesëmarrja në mësim është e vlerësuar me 5%, projekti i kursit me 45% dhe provimi final 50%. Ky raport është i zbatuar për të gjitha tipet e lëndëve.</p>
---	--

Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në to metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Gjykuar metodologjive bashkëkohore të edukimit në Arkitekturë, mund të thuhet se përmbajtja e programit reflekton problematika të kohës e tenton në të njëjtën kohë të përfshijë dhe çështje që shkojnë përtej kontekstit lokal shqiptar. Kjo bën që kurrikula të jetë konkurruese në rang më të gjerë. Gjithashtu shkëmbimet me universitete të huaja në terma të studenteve apo stafit akademik mbeten një mënyrë shume efiçente e përditësimit të problematikave rajonale apo globale.</p> <p>Programi i studimit ofron një edukim në disiplinën e arkitekturës brenda standardeve e kornizës ligjore në vend, nga ana tjetër, duke qenë se kjo e fundit synon arritjen e standardeve evropiane mund të deduktohet në përfundimin se kemi përballë një program i cili është i ngjashëm me atë çka ofrohet në shkolla të ndryshme të arkitekturës në Evropë.</p>
--	---

	Unifikimi i sistemit të krediteve, apo kodifikimi i lendeve të kurrikulës janë elemente të rëndësishëm që mundësojnë transferimin e dijeve.
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Proceset didaktike që përfshin programi i studimit duken të mbuluara mire, ndërkohë mbetet ende për t'u forcuar kërkimi shkencor. Departamenti ka iniciuar një seri aktivitësh që synojnë gjallërimin e kërkimit shkencor si leksionet e hapura, shkëmbimet <i>Erasmus</i>, por sërish mbetet ende pune për të integruar programet e lendeve me temat e kërkimit shkencor. Një avantazh që ka disiplina e arkitekturës, të cilën departamenti e shfrytëzon mirë është lidhja me praktikën profesionale të një pjese të mirë të stafit.</p> <p>Temat e laboratorëve të projektimit apo edhe diplomat shpesh herë janë pjesë e projekteve reale, ndërkohë edhe një pjesë e profesorëve janë arkitektë me profil të pasur profesional. Kjo bën që niveli i mësimdhënies në këto disiplina të jete cilësor.</p>
Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Siç edhe përmendet në studimin e tregut si dokument, ofrimi i këtij programi master përkon me një moment specifik të zhvillimit të industrisë së ndërtimit në Shqipëri. Edhe pse nuk është në pikën e para 5 viteve, sërish mbetet një nga sektorët në rritje të ekonomisë, duke u bërë bazë për rritjen e kërkesës për arkitektë në treg.</p>
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Institucioni ka përgatitur një dokument në të cilin janë pasqyruar nevojat e tregut në lidhje me profesionin e arkitektit.</p> <p>Në metodologjinë e këtij dokumenti përmenden pikat kryesore përmes të cilave strukturohet studimi si; shkalla e punësimit të arkitekteve, numri i kërkesave të maturanëve ndaj degës, kërkesat e punëdhënësve etj.</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Ky program studimi nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Edukimi në arkitekturë synon drejt rritjes së ndjeshmërisë së profesionistit ndaj kontekstit fizik e jo-fizik, për pasojë ndikon pozitivisht në ruajtjen e zhvillimin e qëndrueshëm të vlerave kulturore kombëtare.</p>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave"	N/A

realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezhën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	N/A
Kriteri 2 Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	Struktura e programit të studimit është konform këtij kriteri, referuar edhe dokumentacionit edhe konstatimeve në institucion.
Kriteri 3 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	Kohëzgjatja e studimeve është 5 vite akademike, sasia e punës që studenti realizon është e matur në 300 kredite evropiane ECTS dhe teza e diplomës ka 30 kredite.

Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.

Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;

Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.

Mënyra kryesore e informimit të studenteve mbi përmbajtjen e lendes mbetet syllabusi dhe kontakti i drejtpërdrejt me pedagogun përkatës të lendes. Çdo ore të pare, prezantimi i lendes konsiston në shpjegimin e përmbajtjes, metodës së vlerësimit, objektivave dhe literaturës për çdo lende.

Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;

Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezhën.

Tema e diplomës është e strukturuar në 30 kredite. Në rregulloren e programit të studimit sqarohen etapat dhe mënyra e përmbushjes së detyrimeve për përfundimin e tezës. Zbërthimi i kreditit të diplomës rezulton në 300 orë në auditor dhe 450 orë pune të pavarur të studentit.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Programi i studimit është i strukturuar konform përcaktimeve të ligjit 80/2015. Interpretimi i kreditit nga IAL-ja përkatëse shkon në favor të ngarkesës individuale të studentit, duke ulur atë në auditor. Megjithatë gjykohet e mjaftueshme që të sigurojë kontaktin optimal të studentit me pedagogun për përmbushjen e objektivave të syllabusit.
2. Syllabuset janë hartuar konform VKM 41. Megjithatë gjatë vizitave në institucion e në takimet me grupet e interesit është konstatuar mospërputhje e titullarëve të lëndëve të deklaruara në syllabus dhe personelit që i realizon në praktikë.
3. Nga takimet me stafin akademik dhe autoritetet drejtuese u evidentua tendenca e orientimit të programit të studimit drejt formimit të një arkitekti-restaurator, kjo si reflektim i kërkesës së tregut dhe faktit që është një risi në kontekstin shqiptar.

Rekomandime:

- Rekomandohet të shihet zbërthimi në auditor i tezës, e cila duhet të rezultojë me 20 orë faktike (në auditor) javore në semestrin e dytë të vitit të pestë.
- Rekomandohet të shtohet stafi i kategorisë lektor.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Organizimi i mësimdhënies bëhet kryesisht përmes leksioneve dhe seminareve. në mësimdhënie nuk mungojnë orët e laboratorit, orët e studiove dhe disa lende kanë edhe praktika lëndore. Kjo e fundit është e paqarte. Për shkak të programit, orët laboratorike mund të konsiderohen edhe si ore studio. Megjithatë, ashtu siç është përmendur edhe në kapitullin 4, ambientet ku kryhen këto ore kanë nevojë për përmirësim. Kjo, pasi metodat e përdorura për orët e projektimit janë tradicionalet që njihen në disiplinën e dizenjimit arkitekturor. Një situatë e tillë kërkon përdorimin e infrastrukturës dhe mjeteve të tjera (tavolina të përshtatshme) në ndihmë të një edukimi bazik arkitektonik.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet dhe orët në auditor për to për të pesë vitet:

- Leksione 1080 orë në auditor
- Seminare / Ushtrime 675 orë në auditor
- Laboratorë 915 orë në auditor
- Praktikë profesionale 30 orë në auditor
- Tezë Diplome 300 orë në auditor

Numri total i orëve është 3000, ndërkohë që përqindja që zënë orët e laboratorit e kalon 35%. Për shkak të disiplinës këto orë konsiderohen edhe si orë studio. Është e këshillueshme që këto diferenca/ specifika të shprehen me indikatorë të veçantë. Forma e mësimdhënies, është ajo standarde që zbatohet gjerësisht në departamentet e arkitekturës.

Format e kontrollit të njohurive

Kontrolli i njohurive bazohet në forma kontrolli të vazhdueshme përgjatë semestrit. Studenti e ka detyrim të frekuentoje 50% të orëve të leksioneve dhe 75% të orëve të seminareve. Detyrat dhe projektet e kursit përgjatë semestrit janë kusht për të hyre në provimin përfundimtar që përbën 50% të formës së kontrollit. Kjo formë është efiçente për vetë karakteristikat e departamentit të arkitekturës dhe shkencave kompjuterike.

Shkalla e përvetësimit të dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 1 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F). Nota kaluese është nota 5. Kjo praktikë është mëse e drejtë dhe e barasvlershme në rang kombëtar dhe më tej.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Duke marrë parasysh numrin total të studenteve që ka ky program, duke iu referuar tabelës nr. 15 të RVJ-së (në Aneks) dhe nga biseda në institucion me studentet, konstatohet një numër i konsiderueshëm aktivitetesh ku studentet janë aktive. një praktike për t'u vlerësuar është bashkëpunimi me Bashkinë e Tiranës dhe me vetë Institutet e UMB-së.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Syllabuset përpara zbatimit të Udhëzimit 41
- Tabela e vlerësimit të lektoreve nga ana e studenteve

- Shembull vlerësimi me notën me të ulët dhe më të lartë

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Ky program studimi është hapur me synimin për të përgatitur arkitekte të denje për tregun, për këtë arsye pranimi i studenteve në këtë program bëhet me ane të një testimi i cili ka 2 faza: faza me shkrim dhe intervista me goje. Megjithatë aplikimi i të dy fazave varet edhe nga numri i aplikantëve në të njëjtën kohe. Kriter tjetër pranimi është mesatarja e shkollës se mesme 6/10.

Në këtë program vihet re edhe një numër i madh studentësh të transferuar (32 nga 86 gjithsej).

Duke qene se ky është brezi i pare i studenteve në këtë program, nuk ka studente të diplomuar, por nga vizita e kryer në institucion, dokumentacioni i marre, si dhe nga biseda me studentet rezultoi se 14 studenteve u janë miratuar startimi i temave të diplomave nga 13 të regjistruar në vitin akademik 2014-2015.(Tabela nr. 15 në Aneks) Numri i regjistrimeve varion nga 9-12 studente në vit, tregues i një suate të qëndrueshme. Për shkak të transferimeve gjatë viteve të tjera të studimeve, numri i studentëve diplomante rezulton me i madh se sa ai i të regjistruarve në vitin akademik 2014-2015

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studenteve janë në përputhje me legjislacionin e arsimit të larte në Shqipëri.

- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 16 ne Aneks)

Duke iu referuar Tabelës 16 në aneksin e RVJ-së, numri aktual i studenteve është 76. Mesatarja e studenteve në këtë 5-vjecar të pare është në ngritje në krahasim me mesataren me të cilën janë regjistruar studentet. Sipas të njëjtit standard, mesatarja e notës deri në këto momente (për studentët e vitit të pestë ende në proces) në dalje është 7.71 e cila konsiderohet relativisht e lartë.

- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela 16 në Aneks)

Studente të regjistruar në vit të pare, për here të pare, pranë UMB-se janë 54 studente. Nota mesatare e tyre varion nga 7.1 në 8.2.

- Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Ky program nuk ka nxjerre akoma të diplomuar

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Studentet e transferuar pranë SHLUJ "UMB" përbejnë një numër të konsiderueshëm të numrit total të studenteve në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë, Master me Arkitekture. Raporti i numrit të studenteve të transferuar me numrin total të studentëve është 32/86 studentë, gjë që matematikisht mund të përkthehet si 37.2 % e numrit total të studenteve.

Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të grumbulluara nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve, i takon njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloret e saj. Institucioni në fjale ka një procedurë të mirë paracaktuar, ku një komision *ad hoc* shqyrton dosjet e studenteve që transferohen.

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
 - Tabela me temat e diplomës për student dhe pedagoget udhëheqës;
 - Rregullore akademike
 - Shembull dosjeje transferimi

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.</p>	<p>Studentet që aplikojnë në programin e Studimit të ciklite të dyte (300 kredite) Master i Shkencave (PI) në “Arkitekturë” kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme.</p> <p>Ashtu si edhe ligji e pranon, pranimi në këtë program bëhet në baze të kritereve të vendosura nga vete institucioni (një test paraprak), por edhe në baze të kriterit të mesatares se shkollës se mesme përcaktuar si nivel dhe mënyre llogaritjeje nga Vendimi i Këshillit të Ministrave.</p> <p>Përpara se të pranohen, kandidatet për studente kalojnë edhe nga një interviste me gojë në prani të një komisioni, në formën e një bashkëbisedimi. Kjo praktike bën të mundur identifikimin e talenteve të mundshëm në fushën e Arkitekturës.</p> <p>Është kusht ligjor dhe institucional që studentet të dorëzojnë certifikatën përkatëse të njohjes se gjuhës se huaj përpara diplomimit. Kjo shprehet në rregulloren e programit dhe të institucionit.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>SHLUJ “UMB”, nëpërmjet zyrës se Alumnit dhe Karrierës, informon studentet për mundësitë e punësimit pas diplomimit dhe ofron shërbimin e këshillimit të karrierës.</p> <p>Ndërkohë aplikantët e rinj e marrin këtë informacion nga zyra e pranimit.</p> <p>Në SHLUJ UMB, është zyra e Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë që informon studentet për akreditimin institucional. Nuk është shume e qarte mënyra e ofrimit të këtij shërbimi të studentet, megjithatë nga takimet në institucion u kuptua që në takimin e pare, në zyrën e pranimit, studentet marrin informacionin e pare baze në lidhje me programin dhe institucionin.</p>
Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe	

programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>SHLUJ UMB, me ane të Sekretarisë Mësimore ka informacion të detajuar të paraqitura në regjistrat zyrtare për numrin e studenteve të regjistruar, të transferuar dhe të atyre që janë larguar.</p> <p>Gjithashtu, është e pasqyruar me përpikmëri vlerësimi i studenteve, notat që kanë marre në çdo lende dhe disponon dokumentacionin përkatës nga momenti i regjistrimit deri në fazën e diplomimit.</p>
Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Duke konsideruar që programi në fjale nuk ka akoma të diplomuar, institucioni nuk ka akoma një <i>data</i>base që lidhet me studentet e punësuar pas përfundimit të këtij programi.</p>
Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Duke iu referuar takimeve në institucion me lektorët dhe me studentet, rezultojnë që studentet janë të informuar në lidhje me programin e studimit dhe me rezultatet e vlerësimeve në secilën modul. Kjo, sipas studenteve, arrihet me një rrjet digjital të brendshëm (intranet). Me ane të këtij rrjeti studentet njihen me rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit.</p>
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Duke qene se numri i studenteve të integruar në program është i ulet, stafi akademik dhe studentet, theksojnë që bashkëpunimi i dyanshëm bën të mundur mirëvajtjen e mësimdhënies dhe nxënies. Stafi akademik dhe administrativ angazhohet dhe përkujdeset për studentin.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Ne këtë 5-vjecar të pare të programit Msc (PI) në Arkitekturë studentet janë rekrutuar në përputhje me rregulloren e vendosur nga ligji.</p> <p>Numri i studenteve të regjistruar nder vite dhe cilësia e tyre paraqitet konstante.</p> <p>Studentet janë të mirinformuar për tematikat që kanë të bëjnë me edukimin e tyre, me rezultatet e arritura në modulet mësimore si dhe janë vazhdimisht në përkujdesjen e stafit akademik për të ndihmuar studentet në përzgjedhjen e ambienteve ku ata kryejnë praktikën profesionale.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Departamenti i Arkitekturës në ShLUJ UMB mbështet veprimtaritë kërkimore shkencore. Kërkimi shkencor në këtë institucion është i fokusuar në 3 kategori:

- kërkimi akademik
- kërkimi i orientuar drejt praktikës
- zhvillimi dhe inovacioni pedagogjik

Duke u bazuar në raportet vjetore dhe në RVB-ne e SHLUJ UMB, institucioni synon të investojë në projekte kërkimore. Raporti i vitit 2017 thekson se gjatë vitit akademik organizohen leksione të hapura dhe tryeza të rrumbullakëta. Gjithashtu, nga dokumentacionet e vendosura në dispozicion, si dhe nga takimet me stafin akademik, vihet re rëndësia që i jepet trajnimit të stafit. Si shembull përmenden programet e shkëmbimit me Politeknikun e Barit.

Për t'i ardhur në ndihme stafit dhe jo vetëm, puna kërkimore në SHLUJ UMB funksionon me anë të institucioneve kërkimore, konkretisht; Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barlet" (BIRD), Instituti Shqiptar për Çështjet Publike (AIPA) dhe Instituti i Edukimit Barleti (IEB).

Duke vlerësuar nga këto pikëpamje, kuptojmë që në institucion bëhet kërkim shkencor, por mbetet për të vlerësuar sasia dhe intensiteti i tyre në lidhje me mësimdhënien dhe me programin e arkitekturës. Të dhënat e RVB-se janë në rang institucional, sugjerohet të dokumentohen në rang departamenti.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 18, në Aneks)

Kërkimi shkencor është një element kontraktual i detyrimit të pedagogut kundrejt institucionit. Çdo lektor, bazuar në gradën shkencore që disponon, duhet të ketë disa arritje në fund të një viti akademik; të botojë artikull në gjuhë të huaj, të marrë pjesë në konferenca dhe në 5 vite pune të ngrihet një shkallë më lartë në kualifikim.

- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Të dhënat e paraqitura në Tabelën 18, në rang institucioni tregojnë një pjesëmarrje aktive në kërkim. për dy vitet e fundit tregohet një mesatare 53 publikime për vit, që është tregues aktiv në kërkim. E njëjta gjë mund të thuhet për numrin e projekteve të fituara dhe zbatuara.

Ndërkohë, mungojnë evidencat për numrin e kërkimeve shkencore në procesin mësimor dhe studentet e përfshirë në to. Gjithashtu, do të ishte me vlere një informacion me i detajuar i veprimtarive që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me programin e Arkitekturës. Konkretisht sa nga publikimet, projektet dhe veprimtaritë e tjera kërkimore kanë lidhje me programin e Arkitekturës.

Gjatë vizitës, çdo gjë u paraqit në nivel institucional.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të	

programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik publikon artikuj dhe materiale të tjera shkencore, dhe padyshim si çdo kërkim tjetër ato kanë influence në zhvillimin e disipinës.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Një pjese e personelit akademik ka mbaruar studimet jashtë vendi, kryesisht në Itali. Ata aplikojnë këtë gjuhë në mësimdhënie gjatë mobilitetit të tyre. Gjuha e mësimdhënies në SHLUJ UMB është gjuha Shqipe.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Ka disa evidenca të pakta ku tregohet se institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm të stafit. E njëjta situatë është dhe për ofrimin e mundësive për zhvillim akademik ndërkombëtar. Evidencat tregojnë vetëm programin e shkëmbimit me Universitetin Politeknik të Barit.</p> <p>Sugjerohet të ketë një program të qartë dhe të strukturuar për këto lloj aktivitetesh.</p>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Personeli akademik në UMB SHLUJ disponon një dosje performancë individuale për secilin pedagog, ku janë dokumentuar studimet shkencore dhe angazhimet akademike në këtë program studimi.</p> <p>Gjithsesi, një databazë ku mund të gjenden të gjitha të dhënat në nivel departamenti, fakulteti dhe institucioni do të ishte me aksesueshme nga të gjithë.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Duke u bazuar në RVB-në konstatohet se stafi akademik merret me angazhime akademike. Këto lloj aktivitetesh janë përgjithësisht të lidhura me institutet kërkimore të UMB SHLUJ. Nga dokumentacioni i vene në dispozicion, ekspertet mendojnë se duhet paraqitur me shume përpjekje departamentale/ institucionale për të rritur aktivitetet lidhur me kërkimin shkencor. Këto lloj aktivitetesh mund të financohen nga institucioni ose nga burime të tjera.</p> <p>Projekte kërkimore, konferenca dhe seminare duhet të jene me të shumta në numër dhe të kenë një skedule të përcaktuar.</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

SHLUJ UMB demonstroi që ka bashkëpunime institucionale si në nivel lokal, ashtu edhe në rajonal/ndërkombëtar. Me anë të programeve të Erasmus + vërehet një lëvizje dinamike kundrejt institucioneve jashtë vendit. Në të njëjtën kohë vihet re edhe një bashkëpunim i dyanshëm me Universitetin Politeknik të Barit sidomos në trajtimin e temave të diplomave. Lidhjet me komunitetin e biznesit dhe tregun e punës brenda vendit zënë një vend të rëndësishëm në SHLUJ UMB. Ky bashkëpunim vërehet të jete me shume në trajnime, internshipe dhe mundësim vendesh pune për studentet.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Në RVB-në e SHLUJ UMB raportohen një sërë bashkëpunimesh dhe marrëveshjesh, të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar. Megjithatë nuk ka të dhënë për numrin i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare, për numrin e leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj, numrin e pjesëmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit.

Në RVB mungon tabela ku paraqiten këto të dhëna.

Në takim me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm dhe me studentet rezultoi që ka mobilitet nga SHLUJ UMB drejt Politeknikut të Barit, po jo e anasjella. Kjo për arsye se mësimdhënia është në gjuhën shqipe dhe se studentet e SHLUJ UMB nuk njohin gjuhën italiane.

Për sa i përket infrastrukturës në funksion të kërkimit shkencor, institucioni nuk ka ndonjë laborator apostafat për programin e studimit në fjalë dhe biblioteka ka mangësi të shumta librash. Me termin laborator i referohemi formës së veçantë të mësimdhënies në lëndët me karakter projektual në disiplinën e arkitekturës.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 19 në aneks):

SHLUJ UMB shënon një numër bashkëpunimesh me institucionet shqiptare shtetërore dhe private. Duke u bazuar në RVB-ne, numërohen 31 institucione dhe organizata vendase me të cilat SHLUJ UMB bashkëpunon. Ky bashkëpunim ka si qëllim aktivitete të lidhura me trajnimet, internshipet dhe mundësim vendesh pune për studentet. Në dosjen e RVB-se numërohen 2 bashkëpunime nga komuniteti i biznesit dhe tregut të punës, 4 nga organizatat profesionale dhe 7 nga institucionet qeveritare.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktore të administratës publike dhe biznesit vendas për tu ofruar studenteve trajnime dhe internshipe.
Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitim të njohurive më të mira profesionale	

nga ana e studentit.	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiwe respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>SHLUJ UMB nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiwe respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi. Megjithatë, integrimi i lektorit në module të ndryshme, pune administrative dhe në institute kërkimore çon në një mbingarkese individuale që mund të ndikojë në mbarëvajtjen e programit.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>SHLUJ UMB ka një sere partnerësh të lidhur me sektorin akademik, publik dhe profesional në Shqipëri, rajon dhe me gjerë. Ky rrjet partnerësh ndikon ndonjëherë drejtpërdrejt, ndonjëherë tërthorazi cilësinë e programit të studimit. P.sh. studenti krijon kontakte nga programet e shkëmbimit dhe me praktikantët mësimorë. Ky bashkëpunim është i vlefshëm në mundësimin që i jepet stafit akademik të jete në kontakt me mjedise të tjera akademike dhe profesionale.</p> <p>Praktikat verore sigurohen nga këto marrëveshje por edhe nga kontaktet individuale që lektorët kanë me botën e profesionit.</p> <p>Nuk u evidentua ndonjë analizë specifike ku raportohen përfitimet nga marrëveshjet dhe bashkëpunimet për këtë program në veçanti. një raport i tille do të përmirësonte marrëveshjet dhe do të konsolidonte bashkëpunimet.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>SHLUJ UMB ka marrëveshje të kënaqshme për praktikantët profesionale të studenteve me institucione publike dhe private në ndihmë të një përvoja të mire praktike. Institucioni ka lidhur disa marrëveshje me universitetet e huaja, me të cilat ka bashkëpunuar për programe mobiliteti.</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE (PI) NË ARKITEKTURË

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës SWOT (Strengths - pikat e forta, Weaknesses - pikat e dobëta, Opportunities - mundësitë, Threats - pengesat).

a. Pika të forta:

- 1) **Menaxhimi i stazheve dhe ofrimi i praktikave nxit zhvillimin e njohurive bazuar në praktike.** Një nga avantazhet e këtij institucioni është që ka hartuar një politike të zhvillimit të lëndëve me rëndësi të programit të studimit Master i Shkencave (PI) në Arkitekturë (ato me karakter projektual) në bashkëpunim me studio dhe atelie të cilat kanë profil të konsoliduar në tregun privat. Në formimin në arkitekturë ky fakt mbetet i një rëndësie të veçantë. Kjo favorizohet edhe nga numri i vogël i grupeve

mësimore ne çdo vit akademik. Kjo formë kontakti me kompanitë apo studiot e projektimit që operojnë në tregun e lirë ndiqet edhe për praktikant profesional.

- 2) **Marrëdhënia me Institutet Kërkimore** Për t'i ardhur në ndihme stafit dhe jo vetëm, puna kërkimore në SHLUJ UMB funksionon me anë të institucioneve kërkimore, konkretisht; Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barlet" (BIRD), Instituti Shqiptar për Çështjet Publike (AIPA) dhe Instituti i Edukimit Barleti (IEB), etj. Edhe pse jo të funksionalizuar në total të performancës së tyre, institutet mbeten një mekanizëm shumë fleksibël për të nxitur kërkimin shkencor e rritur kontaktin e institucionit me aktore të tjerë si OJF, ente shtetërore etj.
- 1) **Tendencat për të ofruar një profil të munguar në tregun e profesionisteve të arkitekturës.** Siç edhe përmendet në disa pika të raportit, por edhe duke gjykuar mbi gjendjen aktuale të tregut të profesionisteve në vendin tonë, ideja për të qenë konkurrues me një profil specifik të arkitektit mbetet për t'u vlerësuar. Ky fakt lidhet edhe me gjendjen e studimeve lidhur me trashëgiminë e ndërtuar në vendin tonë. Shtimi i një profili i cili shkrin elemente të edukimit në arkitekturë me koncepte që variojnë që nga restaurimi e deri tek konservimi paraqitet interesant. Megjithatë kërkohet reflektim në një shkallë shumë më të madhe të kësaj perspektive në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve
- 2) **Pjesa e stafit të angazhuar në laboratorët e projektimit kanë një profil të spikatur në fushën profesionale, duke ndikuar në mënyrë direkte në cilësinë e mësimdhënies dhe raportit direkt të studentit me profesionin dhe tregun.** Angazhimi i kësaj kategorie të stafit kthehet në çernierën që mundëson pikat e kontaktit të studenteve me ambientin e tregut dhe profesionisteve të lirë të disiplinës.

b. Pika të dobëta:

- 1) **Infrastruktura: godina nuk përmbush siç duhet kërkesat lidhur me ambientet e nevojshme për disiplinën e programit.** Siç është shprehur në pikën përkatëse të raportit, në terma sasiorë infrastruktura fizike paraqitet brenda standardeve. Megjithatë, nëse i referohemi një diskutimi në terma cilësie e duke konsideruar kërkesat specifike që ka disiplina, gjendja fizike e ambienteve didaktike, sidomos laboratorët e projektimit kërkon përmirësim. Arsyeja kryesore e gjendjes lidhet me faktin që godina ku zhvillohet mësimi nuk është projektuar për të qenë institucion arsimor dhe është përshtatur.
- 2) **Furnizim i kufizuar i librave kryesore në programin e Arkitekturës, mungesa e aksesit në burimet e bibliotekave elektronike, gjë që çon në mospërdorim të bibliotekës nga studentet.** Edhe në këtë rast, kemi një hapësirë fizike të përshtatshme në terma sasiorë, por që kërkon rikonceptim në sensin e menaxhimit të informacionit dhe të kontaktit me librin në çdo lloj forme.
- 3) **Mbingarkesa e Stafit Akademik.** Numri relativisht i vogël i stafit me gradën shkencore Doktor ka rezultuar në mbingarkimin në sasi por edhe në numër disiplinash të stafit aktual që posedon këtë gradë shkencore. Fokusimi i tyre në komponentin e mësimdhënies bën që të mos kenë angazhim maksimal në procese të kërkimit shkencor.
- 4) **Mungesa e grupeve kërkimore në njësinë bazë** që siguron rezultate kërkimore
- 5) **Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë** ka nevojë të mirë-strukturohet në terma të procedurave që sigurojnë ndërveprimin e të gjitha njësive në funksion të plotësisë të mangësive të hasura nga raportet periodike të kontrollit.

c. Mundësitë:

- 1) Zhvillimi i modulit "gjuhë italiane", që nxit mobilitetin e studenteve dhe u mundëson atyre përfitim nga botimet ndërkombëtare
- 2) Zhvillimin e modulit "Dizajnim Digjital", që përgatit studentin për kërkesat e tregut. Orientimi i programit drejt këtij drejtimi në fakt përbën një mundësi të mirë që mbështetet mbi kapacitetet aktuale

dhe mënyrës se si është formuluar aktualisht Departamenti, me një komponentë nga shkencat kompjuterike.

- 3) Vijimi i bashkëpunimeve me partnere ndërkombëtarë si mënyrë nxitjeje të mobilitetit të stafit akademik dhe studenteve
- 4) Fuqizimi i instituteve si pika kontakti me boten e publicistikës, atë kërkimore, shoqërisë civile etj.
- 5) Përmirësimi i sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë.
- 6) Përmirësimi i infrastrukturës fizike, sidomos ajo e lidhur me proceset mësimore dhe biblioteka.
- 7) Hartimi i një Plani Veprimi si dhe i dokumenteve të detajuara strategjike, dokumente këto ku mund të vendosen objektiva, afate kohore dhe instanca përgjegjëse për realizimin e objektivave.
- 8) Shtimi i stafit akademik efektiv

d. Pengesat:


- 1) **Mungesa e individëve me tituj në nivel kombëtar, në fushën e arkitekturës.** Ky fakt është një pengesë për çdo institucion që ofron programe studimi lidhur me Arkitekturën dhe Shkencat e Ambientit të Ndërtuar.
- 2) Atashimi i programit të studimit **në një fakultet dhe departament me natyrë të ndryshme** nga disiplinat ambientit të ndërtuar ku bën pjese dhe arkitektura.
- 3) **Infrastruktura fizike e limituar.** Fakti që ndërtesa aktuale është përshtatur nga një funksion tjetër përbën një kufizim duke iu referuar shkallës së ulët se fleksibilitetit që ajo ofron.

Rekomandime:

1. *Rekomandohet hartimi i dokumenteve strategjike në nivel njësie bazë/kryesore ku artikuloohen vizionet dhe misioni i programit të studimit si dhe mënyrat e përmirësimit të vazhduar të tij.*
2. *Rritja e numrit të stafit të kategorisë lektor me synim uljen e ngarkesës vjetore të stafit aktual si dhe uljen e numrit të disiplinave që çdo anëtar jep. Kjo do të shkonte në favor të rritjes së cilësisë.*
3. *Të përmirësohet gjendja e botimeve lidhur me programin e studimit në bibliotekën e universitetit*
4. *Të përmirësohen në terma fizike e në nivel mobilimi ambientet dedikuar laboratorëve të projektimit*
5. *Njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit të përpilojë raport vjetor të punës didaktike dhe kërkimore.*
6. *Strukturimi i departamentit në grupe mësimore të cilat janë përgjegjëse për të gjitha nivelet e analizave që bëhen në nivel lënde, grup-lëndësh apo edhe kurrikulës në tërësi.*
7. *Përpilimi i një metodologjie e cila e bën plotësimin e pyetësorit të detyrueshëm për studentin, me synim rritjen e përqindjes së pjesëmarrjes së tyre dhe të krijuarit të një opinionimi me të qëndrueshëm lidhur me performancën e stafit në auditor.*
8. *Rekomandohet të shihet zbrërthimi në auditor i tezës, e cila duhet të rezultojë me 20 orë faktike (në auditor) javore në semestrin e dytë të vitit të pestë.*

SWOT ANALYSIS

a. Strengths:



- 1) **Organization and management of the internships fosters practice based knowledge development.** One of the advantages of this institution is that it has developed a policy for development of important subjects of the Master of Science Program in Architecture (design based subjects) in a good collaboration with design studios that have a consolidated profile in the private sector. In education of an architect, this fact has a particular importance. In this institution, this is favoured by the small number of teaching groups in each academic year. This way of collaboration with design companies and studios that operate in the free market, is followed for professional practices as well.
